



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ)**, në mbështetje të nenit 64, paragrafi 2 dhe nën paragrafëve 2.1, 2.2 dhe 2.3, nenit 6, 7, 8, 9, 10, 11, 85 dhe 95 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), si dhe nenit 12, 20 dhe 29, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL), me datën 06.03.2024, miraton këtë:

## **RREGULLORE ZGJEDHORE NR. 03/2024**

### **KRIJIMI, KUNDËRSHTIMI DHE KONFIRMIMI I LISTËS SË VOTUESVE**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Kjo Rregullore përcakton të drejtën e votës, ndërrimin e Qendrës së Votimi (QV), procesin e krijimit, kundërshtimit, konfirmimit, publikimit dhe certifikimit të Listës së Votuesve (LV).

#### **Neni 2**

#### **E drejta e votës**

Të drejtë vote në Republikën e Kosovës kanë shtetasit që kanë arritur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, qoftë edhe në ditën e zgjedhjeve.

#### **Neni 3**

#### **Procesi i krijimit të listës së votuesve (LV)**

1. KQZ mban LV dhe siguron që e njëjta bazohet në të dhënat e sakta, të përditësuara dhe më të fundit të Regjistrit Qendror Civil (RQC), dhe në mënyrë sistematike largon nga lista personat e vdekur dhe personat që kanë hequr dorë nga shtetësia. Kjo listë, përmban:
  - 1.1. Ekstraktin e fundit në dispozicion nga RQC të të gjithë personave me të drejtë vote, të cilët janë regjistruar si shtetas të Republikës së Kosovës, sipas Ligjit për Shtetësinë;
  - 1.2. Të gjithë shtetasit që jetojnë jashtë Kosovës, të cilët pas regjistrimit të suksesshëm, janë përfshirë si votues jashtë Kosovës.

2. Me qëllim të saktësimit të LV dhe konfirmimit të së drejtës për votim, KQZ kërkon informata, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në bazën e të dhënave dhe regjistrat e institucioneve kompetente: Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Agjencisë Kadastrale, Agjencisë për Regjistrim Civil dhe Administratës Pensionale.
3. Shërbimi votues (SHV) menjëherë pas shpalljes së zgjedhjeve kërkon nga Agjencia për Regjistrim Civil (ARC) ekstraktin e parë (1) të RQC, i cili duhet të pranohet nga KQZ, jo më vonë se dy (2) ditë pas shpalljes së datës së zgjedhjeve.
  - 3.1. Ekstrakti i RQC duhet të përmbajë këto të dhëna të votuesve:
    - 3.1.1. emrin dhe mbiemrin;
    - 3.1.2. numrin personal të identifikimit;
    - 3.1.3. datën e lindjes;
    - 3.1.4. gjininë;
    - 3.1.5. emrin e njërit prind;
    - 3.1.6. datën e regjistrimit civil;
    - 3.1.7. kodin e qendrës komunale të regjistrimit civil;
    - 3.1.8. kodin e komunës dhe emërtimin e komunës;
    - 3.1.9. emrin e vendbanimit;
    - 3.1.10. adresën, ku përfshihet emri i rrugës dhe numri i hyrjes;
    - 3.1.11. kodet e përdorura të vendbanimeve (P-Code dhe UD-Code), për aq sa është e nevojshme.
4. SHV menjëherë pas shpalljes së zgjedhjeve kërkon nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës të dorëzojë listën e personave të cilëve, u është marrë zotësia e veprimit me vendim gjyqësor e cila listë duhet të pranohet nga KQZ jo më vonë se shtatë (7 ditë) pas shpalljes së datës së zgjedhjeve. Të dhënat personale të këtyre personave duhet të përfshijnë: emrin, mbiemrin, datën e lindjes, numrin personal dhe adresën.
5. SHV, do t'i largojë nga LPV emrat e personave që me vendim gjyqësor të formës së prerë u është marrë zotësia e veprimit.
6. SHV obligohet t'i caktojë votuesit në QV dhe të hartojë raport me shkrim i cili, miratohet nga KQZ, jo më vonë se dymbëdhjetë (12) ditë pas shpalljes së datës së zgjedhjeve.

## **Neni 4**

### **Ndërrimi i QV**

1. Në vitet jo zgjedhore, KQZ përmes SHV kërkon nga ARC, së paku dy herë në vit, ekstraktin me të dhënat e shtetasve me të drejtë vote me qëllim të informimit të votuesve për QV dhe mundësinë e ndërrimit të QV, në platformën elektronike të KQZ.
2. SHV përmes platformës elektronike u mundëson shtetasve me të drejtë vote, të kenë qasje në informatat e tyre lidhur me QV ku janë caktuar dhe mundësinë për të ndërruar QV.
3. Votuesi ka të drejtë të kërkojë ndërrimin e QV brenda komunës ku është i regjistruar me vendbanim.
4. Kërkesën për ndërrimin e QV, votuesi mund ta bëjë në çdo kohë deri në dyzet e pesë (45) ditë para ditës së zgjedhjeve, përmes:
  - 4.1. platformës elektronike të KQZ;
  - 4.2. në zyrat e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), Shtojca I – Formulari për ndryshimin e QV.
5. Kërkesa për ndërrim të QV përmes platformës elektronike bëhet duke e bashkëngjitur njërin nga dokumentet e identifikimit: letërnjoftim, pasaportë apo lejen e vozitjes dhe fotografinë e shtetasit me dokument identifikues në dorë.
6. Kërkesat shqyrtohen dhe miratohen nga KKZ. Ndryshimet reflektohen në kohë reale. Shërbimi votues sigurohet që të bëjë auditimin e vendimeve të KKZ.
7. KQZ kujdeset që të realizojë një fushatë të informimit publik për gjetjen dhe mundësinë e ndërrimit të QV.
8. Për nevoja të informimit të votuesve, KQZ do të aktivizojë linjën telefonike, e cila do të ju mundësojë qytetarëve të kërkojnë sqarime dhe informata. Kjo linjë telefonike, do të jetë në dispozicion të votuesve, në çdo kohë gjatë orarit të punës, duke përfshirë edhe ditën e zgjedhjeve.
9. Së paku një herë në vit, shërbimi votues bënë analiza dhe krahasime lidhur me numrin e votuesve në bazë të gjinisë, grup moshave, VV, QV, komunës dhe në nivel vendi.

## **Neni 5**

### **Publikimi i Listës Preliminare të Votuesve**

1. KQZ, jo më vonë se dymbëdhjetë (12) ditë pas shpalljes së datës së zgjedhjeve, bënë publike Listën Preliminare të Votuesve (LPV), në platformën elektronike dhe në zyrat KKZ, në formatin elektronik.

- 1.1. LPV përmban: emrin dhe mbiemrin, datën e lindjes, gjininë, kodin e QV, emërtimin e QV, vendndodhjen e QV, kodin e komunës dhe emërtimin e komunës.
2. Lista e votuesve jashtë Kosovës, nga fillimi i periudhës së regjistrimit publikohet dhe përditësohet në kohë reale përmes platformës elektronike në faqen zyrtare të KQZ dhe përmban të dhënat e votuesve të regjistruar suksesshëm, si: mbiemrin dhe emrin, vitin e lindjes, shtetin ku jeton dhe komunën në Republikën e Kosovës.
3. KQZ i ofron qasje në LPV, personit kontaktues të subjektit politik të certifikuar në zgjedhje, në formë elektronike.
4. KQZ, me kërkesë së organizatës vëzhguese të akredituar për zgjedhje, ofron qasje në LPV.
5. Subjektet politike të certifikuara dhe vëzhguesit e akredituar, i trajtojnë të dhënat nga LPV me konfidencialitet, bazuar në Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

## **Neni 6**

### **Periudha dhe procesi i kundërshtimit dhe konfirmimit të LPV**

1. Periudha e kundërshtimit dhe e konfirmimit, do të thotë periudha gjatë së cilës votuesit me të drejtë vote mund t'i kundërshtojnë pasaktësitë ose lëshimet në LPV, në pajtim me procedurat e përcaktuara me këtë Rregullore dhe të gjitha dispozitat ligjore në fuqi.
2. Periudha kundërshtimit dhe konfirmimit fillon, jo më vonë se dymbëdhjetë (12) ditë pas ditës së shpalljes së zgjedhjeve dhe përfundon, jo më vonë se 2 ditë pas përfundimit të periudhës për ndërrimin e QV.
3. Çdo person me të drejtë vote që nuk figuron në LPV, është caktuar gabimisht në qendër tjetër të votimit apo ka të dhëna të tjera të pasakta, mund të kërkojë nga KQZ rishikimin e LPV përmes sistemit elektronik apo duke u paraqitur në KKZ, me njërin nga dokumentet si në vijim:
  - 3.1. letërnjoftim të vlefshëm;
  - 3.2. pasaportë të vlefshme;
  - 3.3. lejen e vozitjes të vlefshme.
4. KKZ menjëherë pas pranimit të kundërshtimit nga pala, e procedon rastin në KQZ.
5. Në rast se kundërshtimi ka të bëjë me ndërrimin e QV apo lidhur me ndonjë pasaktësi tjetër, e cila mund të përmisohet nga KQZ, atëherë ndërmerren veprime të menjëhershme për përimisim. KKZ menjëherë pas njoftimit për përmisimin e gabimit, e njofton palën.

6. Në rast se kundërshtimi ka të bëjë me një shtetas i cili nuk figuron në LPV, KKZ obligohet që menjëherë rastin ta paraqet në KQZ.
  - 6.1. KQZ ndërmerr veprime të menjëherëshme për trajtimin e rastit në koordinim me ARC.
  - 6.2. KKZ pas njoftimit nga KQZ, e njofton menjëherë palën për vendimin e KQZ.
  - 6.3. Në rast se KQZ përmes ARC evidenton se një person me arsye nuk është përfshirë në LPV, njofton KKZ për arsyen e refuzimit. KKZ menjëherë pas pranimit të vendimit nga KQZ njofton palën për të drejtën e ankesës në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), brenda dyzet e tetë (48) orëve.
  - 6.4. Për të gjitha rastet e tilla, KQZ obligohet që të krijojë një bazë të shënimeve për evidentim, të cilat kontrollohen dhe krahasohen me të dhënat që përmban ekstrakti i RQC, në mënyrë që të sigurohet se votuesit të përfshihen në LPV.
7. Votuesi që identifikon veten përmes dokumentit të identifikimit, siç parashihet në paragrafin 3 të këtij neni, mund ta kundërshtojë pasaktësinë e LPV, për ndonjë emër të votuesit për të cilin pretendon se nuk duhet të figurojë në LPV. Ankesa duhet të parashtrohet në PZAP.
8. Vendimet përfundimtare nga PZAP apo Gjykata Supreme që kanë të bëjnë me përfshirjen apo përjashtimin e emrit të votuesit nga LPV, janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga KQZ.
9. SHV sigurohet që të pranojë ekstraktin e dytë (2) të RQC, jo më vonë tridhjetë (30) ditë para përfundimit të periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit të LPV, për përditësim të LPV.

## **Neni 7**

### **Certifikimi i Listës Votuese**

1. KQZ pranon ekstraktin e tretë dhe të fundit të RQC, jo më vonë se dyzet (40) ditë para ditës së zgjedhjeve.
2. KQZ do t'i caktojë votuesit nëpër Vendvotime (VV), sipas renditjes alfabetike të mbiemrave dhe emrave të votuesve.
3. LV e votuesve të caktuar në të njëjtën QV, përgatitet në mënyrë që asnjë VV brenda QV nuk tejkalon 750 votues. Përjashtimet nga kjo rregull mund të autorizohen nga KQZ.
4. LV do të krijohet për secilin VV, dhe përmban këto të dhëna:
  - 4.1. logon e KQZ;

- 4.2. kodin e VV, i cili është i gjeneruar me barkod;
  - 4.3. numrin e faqeve;
  - 4.4. numrin rendor;
  - 4.5. mbiemrin dhe emrin e votuesit;
  - 4.6. datën e lindjes së votuesit;
  - 4.7. numrin personal të identifikimit, i cili është edhe i gjeneruar me barkod.
5. KQZ përgatitë LV të veçantë për VV jashtë vendit dhe përmban informatat e njëjta sipas paragrafit 4 të këtij neni.
  6. LV certifikohet nga KQZ më së voni 35 ditë para ditës së zgjedhjeve. Raporti i certifikimit të LV, përmban të dhënat si në vijim:
    - 6.1. llojin e zgjedhjeve;
    - 6.2. numrin e përgjithshëm të votuesve;
    - 6.3. numrin e qendrave të votimit;
    - 6.4. numrin e vendvotimeve;
    - 6.5. krahasimet numerike me zgjedhjet e fundit të mbajtura;
    - 6.6. informatat për periudhën e shërbimit të votuesve për ndërrimin e QV;
    - 6.7. informatat për periudhën e kundërshtimit dhe konfirmimit të LV;
    - 6.8. informatat për votim jashtë Kosovës si në vijim:
      - 6.8.1. periudhën e regjistrimit për votim jashtë Kosovës;
      - 6.8.2. numrin e votuesve sipas mënyrës së votimit;
      - 6.8.3. numrin e votuesve sipas shtetit të regjistrimit dhe komunës në Kosovë;
      - 6.8.4. krahasimet numerike me zgjedhjet e fundit të mbajtura
    - 6.9. informatat numerike për çdo komunë, ku përfshihet:
      - 6.9.1. numri votuesve;
      - 6.9.2. numri i QV për çdo komunë;
      - 6.9.3. numri VV;

6.9.4. informatat për ndarjen e votuesve në vendvotime.

7. Lista e njëjtë e votuesve, që është shfrytëzuar për zgjedhjet komunale, do të përdoret për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, duke përfshirë personat që në ndërkohë, në ditën e zgjedhjeve, mbushin 18 vjet dhe duke përjashtuar personat që heqin dorë nga shtetësia.

## **Neni 8**

### **Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja Nr.03/2023 Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës së Votuesve, e datës 09.03.2023.
2. SHV në afat prej 90 ditësh nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore, harton procedurë të veçantë për procesin e krijimit të LV, ku do të përfshihet: ruajtja dhe përpunimi i të dhënave, mënyra e caktimit të votuesve në QV, krijimi dhe shtypja e LV, dhe shkatërrimi i të dhënave pas procesit zgjedhor.

## **Neni 9**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

**Kryesues**

**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

---

**Kreshnik Radoniqi**